



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR FURNIZIM (ME NJE OPERATOR)

KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit te cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga “Fadil Ferati” nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, ne cilësinë e porositesit te sherbimeve të Autoritetit Kontraktues në njëren anë;

dhe

“SHKËMBI” SHPK të cilën e përfaqëson z. Musa Metaj, në cilësinë e menaxherit Zona Industriale ne Istog, me Nr. Unik të Rexhistrimit te biznesit: 810296039 ne vazhdim “Furnizuesi”, ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet si me poshtë:

MIRËMBAJTJA E RRUGËVE TE RENDIT TE IV-të

Nr. I prokurimit	633-18-1801-2-1/FA060
Nr. I brendshëm	633 / 020 / 021 / 121

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

MIRËMBAJTJA E RRUGËVE TE RENDIT TE IV-të

Autoriteti Kontraktues bënë blerjen vetëm në emër të vetë Autoritetit]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indicative që Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të

detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëra; të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me NËNSHKRIMIN E SAJË PERKATESISHT ME DATË 30.06.2020 DHE DO TË PERFUNDOJË ME SE LARTI DERI ME 29.06. 2022 PASI KONTRAKTORI TE DESHMOJE SIGURINË PER EKZEKUTIMIN E KONTRATËS ME VLEFSHMERI PREJ 25 MUAJVE, NGA DATA E NENSHKRITIT TE KONTRATËS.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e te gjitha FURNIZIMEVE – SHERBINMEVE do të jetë: **29.06.2022.**

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit dhe shërbimeve tjera do të jenë në rrugët në FSHATRAT E TERITORIT TE KOMUNËS SË ISTOGUT – BAZUAR NE REKOMANDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES.

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi i datës: **27.05.2020**

Vlera totale indikative e kontratës është: **47.910,00 Euro.**

Dhe me shkronja: /Katëreshtatë mijë nëntë çindëdhjetë zero zero/

4.2 Ky çmim mund të ndryshojë sipas: (Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 38 paragrafi 2, lejon +- 30% e vlerës së kontratës) po qe se për këtë paraqitet nevoja nga Autoriteti Kontraktues. Po qe se urdherblerjet kalojnë sasinë totale të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + 30%), pa marrë parasysh datën origjinale të nënshkrimit, e njëjta shkeputet automatikisht.

4.3 Çmimi i përmendur për NJËSI në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.4 [Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë

4.5 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

Plani per menaxhimin e kontrates

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.





6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tijë.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komunën e Istogut

Për Kontraktuesin:
Shkëmbi Shpk

Emri:	<i>Zizë Bujupaj</i>	Emri:	<i>“Shkëmbi” shpk</i>
Pozita:	<i>Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit</i>	Pozita:	<i>Musa Metaj M e n a x h e r</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<i>29.06.2020</i>	Data:	<i>29.06.2020</i>
Vula:		Vula:	

PJESA III E KONTRATES: kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	<i>Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.</i>
	2.2	<i>Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe dhe gjuha serbe</i>
Siguria e ekzekutimit	8.1	<i>Vlera e sigurisë së ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës, për periudhën prej 25 muaj.</i>
Cilësia e furnizimeve	16.2	<i>Të gjitha furnizimet duhet të jenë të cilësisë së lartë. Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas furnizimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se furnizimeve janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë.</i>
Dorëzimi	19.3	<i>Dorëzimi i furnizimeve duhet të bëhet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	<i>Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 30.1.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	<i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.</i>

KOMUNA E ISTOGUT

TITULLI I AKTIVITETIT: MIRËMBAJTJA E RRUGEVE LOKALE TE RENDIT - IV

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia e perafert (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
1	Furnizimi dhe Transporti i zhavorit (materiali prej gurit te thyer gelqeror 0-31mm)	m ³	1500	6	9000
2	Furnizimi, Transporti dhe Shpërndarja e zhavorit me gredër (materiali prej gurit te thyer gelqeror 0-31mm)	m ³	4500	8	
3	Planifikimi dhe Gërmimi me Bulduzet apo me greder	orë	100	20	36000
4	Furnizimi me gypa betoni Ø 400	copë	40	5	200
5	Furnizimi me gypa betoni Ø 500	copë	30	6	180
6	Furnizimi me kapak betoni për mbulimin e pusetave	copë	15	2	
7	Hapja e kanaleve anësore	m'	500	1	500
TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT					47910